



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2023:293346

Datë: 02.07.2024

Numri i dokumentit: 05882791

**P.nr. 2023:293346**

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA RAHOVEC**/Departamenti i Përgjithshëm–Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Mizahir Shabani, me bashkëpunëtorin profesional Afrim Gashi, duke vendosur në lëndën penale kundër të akuzuarit M.G nga fshati Sapniq, Komuna e Rahovecit, për shkak të veprës penale ngasja në gjendje të paaftë apo të dehur nga neni 371 par. 3 lidhur me par. 1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Gjakovë/Departamenti Përgjithshëm PP/II.nr.1718/2023 të datës 17.01.2024, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesor dhe publik në prezencën e përfaqësuesit të akuzës Prokurori i Shtetit Uridia Caka dhe të akuzuarit së bashku me mbrojtësin-avokatin Z.Z, më datë 11.06.2024, mori dhe publikisht shpalli këtë:

## A K T G J Y K I M

### I akuzuari,

**M.G**, nga i ati V dhe e ëma H, e lindur P, i lindur më dt....., në fshatin Sapniq, Komuna e Rahovecit, ka të kryer shkollën fillore, i martuar, i ati i tre (3) fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal ....., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

## ËSHTË FAJTOR

### S e p s e:

Me dt. 20.11.2023 rreth orës 11:16.10.2023 në fshatin Sapniq, Komuna e Rahovecit, i pandehuri në kundërshtim me nenin 233 par. 2 të Ligjit Nr.05/L-088 për rregullat e trafikut rrugor, drejton automjetin në gjendje të dehur me çka shkakton vet aksident i cili rezulton me lëndim të rëndë trupor për të dëmtuarën A.D-bashkëjetuesen e tij, në atë mënyrë që ditën kritike i pandehuri paraprakisht konsumon alkool dhe pas disa orësh derisa ishte duke drejtuar automjetin e tij W me targa ....., ku së bashku me të ishte edhe e dëmtuara, kur arrin në hyrje të fshatit Sapniq, e humb kontrollin mbi automjetin e tij dhe del jashtë rrugës kryesore në anën e djathtë të drejtimit të lëvizjes, ku e godet një shtyllë të energjisë elektrike, me çka të dëmtuarës i shkakton lëndime të rënda trupore dhe atë ndrydhje të indeve të buta në regjionin e kraharorit, thyerje e shumëfishtë me zhvendosje kockore të mbi gjurit të djathtë dhe thyerje e shumëfishtë e kockës së kapakut të gjurit të djathtë,

plagë shqyese ndrydhëse në regjionin e gjurit të djathtë, regjionin e jashtëm, të shkaktuara nga veprimi mekanik i mjetit të fortë mbretës (jo i mprehtë) të përshkruara si në Akt Ekspertizën mjekoligjore të Dr. N.U, të datës 17.12.2023, ashtu që pas matjes së pranisë së alkoolit në gjak nga ana e zyrtarëve policor rezulton 0.79 promila prania e alkoolit në gjak.

- **Këso dore ka kryer veprën penale Ngasja në gjendje të paaftë apo të dehur nga neni 371 par. 3 lidhur me par.1 të KPRK-së.**

Andaj, gjykata në bazë të dispozitave të neneve 4, 6, 7, 17, 38, 46 par.1 pika 1.1, 47, 48, 49, 69, 70, nenit 371 par.3 lidhur me par, 1 të KPRK-së, dhe nenit 364 të KPPK-së, të akuzuarit i shqipton:

### **DËNIM ME KUSHT**

Dënimin me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet, nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afat prej dy (2) viteve, nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.

Në kuptim të nenit 65 të KPRK-së, së bashku me dënimin kryesor i shqipton:

### **DËNIM PLOTËSUES**

Të akuzuarit **M.G**, i merret leja e vozitjes e kategorisë “B” dhe i ndalohet marrja e lejes së re gjatë periudhës prej një (1) viti, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

E dëmtuara A (H) D, nga fshati Sapniq, Komuna e Rahovecit për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontest të rregullt civil.

Detyrohet i akuzuari që të paguajë shpenzimet e paushallit gjyqësor në shumën prej tridhjetë (30) Euro, nëse mer të ekspertizës mjeko ligjore në shumë prej njëzet (20) euro, si dhe në emër të kompensimit për viktimat e krimit shumën prej njëzet (20) Euro, në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

## **A r s y e t i m**

### **1.Ecuria e procedurës penale**

Prokuroria Themelore në Gjakovë – Departamenti i Përgjithshëm, ka paraqitur aktakuzën PP/II.nr.1718/2023 të datës 17.01.2024, kundër të pandehurit M.G nga fshati Sapniq, Komuna e Rahovecit, për shkak të veprës penale Ngasja në gjendje të paaftë apo të dehur nga neni 371 par. 3 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit fillestarë me datë 11.06.2024, ku prezent kanë qenë përfaqësuesi i akuzës Prokurori i Shtetit Uridia Caka, i akuzuari së bashku me mbrojtësin-avokatin Z.Z, i caktuar sipas detyrës zyrtare dhe e dëmtuara.

Gjyqtari i vetëm gjykues e ka ftuar të akuzuarin që të përcjell me vëmendje zbatimin e shqyrtimit gjyqësor dhe në kuptim të nenit 241 të KPPK-së, e ka udhëzuar të akuzuarin për të drejtën e tij për të mos u deklaruar në çështjen e tij ose të mos përgjigjet në pyetje dhe nëse ai deklaron për

çështjen, ai nuk detyrohet të inkriminoj vetveten ose të afërmit, e as të pranoj fajësinë, të mbrohet vetë ose nëpërmjet ndihmës juridike të mbrojtësit sipas zgjedhjes së tij, të kundërshtoj aktakuzën dhe pranueshmërinë e provave të paraqitura në aktakuzë.

Pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të Shtetit i cila ka qëndruar në tërësi pranë saj, i akuzuari ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën për të cilën akuzohet.

Gjyqtari i vetëm gjykues pasi është bindur se i akuzuari e ka kuptuar aktakuzën, të njëjtit i ka dhënë mundësinë që të pranojë ose të mos e pranojë fajësinë, si dhe e ka njoftuar lidhur me efektet dhe pasojat e pranimin të fajësisë.

I akuzuari ka deklaruar se e pranon fajësinë sipas të gjitha pikave të aktakuzës, e ndien veten fajtor për këtë veprë penale për të cilën ngarkohet dhe se ndien keqardhje për rastin që ka ndodhur, kjo është hera e parë që ndeshet me ligjin dhe i premtoj gjykatës se në të ardhmen një veprim i tillë nuk do të përsëritet, kërkoj nga gjykata që të ketë mirëkuptim në shqiptimin e dënimit pasi që në këtë rast e të dëmtuarën e ka bashkëshorte si dhe është i vetmi mbajtës i familjes.

Mbrojtësi i të akuzuarit – avokati Z.Z, ka deklaruar se duke marrë parasysh se klienti i tij e pranon fajësinë dhe se ai është në gjendje të dobët ekonomike i cili merret me bujqësi dhe disponon vetëm një hektar tokë, ai kurr nuk ka qenë i dënuar për ndonjë veprë penale apo kundërvajtje, kjo është hera e parë që i ka ndodhur në këtë fatkeqësi. Prandaj i propozoj gjykatës që dënimi i tij të jetë më i butë në mundësi që të jetë i kushtëzuar. Edhe me dënimin e këtillë do të arrihet qëllimi i dënimit aq më tepër duke marrë parasysh se e dëmtuara është bashkëshortja e tij jashtëmartesore, dhe se ai siguron të ardhurat për familjen prej gjashtë (6) anëtarësh.

Prokurorja e Shtetit jep mendimin lidhur me pranimin e fajësisë e cila ka deklaruar se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, pasi që pranimin e fajësisë e ka bërë me vullnet të lirë dhe pasi i ka kuptuar të drejtat, respektivisht favoret dhe pasojat e pranimin të fajësisë, po ashtu duke marrë për bazë se aktakuza ka mbështetje në provat materiale dhe personale në bazë të cilave është paraqitur gjendja faktike në dispozitiv të saj, ku edhe përmbushen të gjitha elementet e veprës penale për të cilat ngarkohet i akuzuari. I propozoj gjykatës që i akuzuar të shpallet fajtor dhe ti shqiptoj një dënim të paraparë ligjor duke pasur parasysh shkallen e përgjegjësisë dhe rrezikshmërisë së veprës penale për të cilën ngarkohet. Gjithashtu me rastin e vlerësimit dhe caktimit të dënimit të ketë parasysh edhe qëllimin e dënimit duke i vlerësuar rrethanat lehtësuese, pranimin e fajësisë në këtë shqyrtim fillestar, pendimin e tij, premtimin se në të ardhmen nuk do të kryej ndonjë veprë penale ndërsa si rrethana rënduese të ketë parasysh rrezikshmërinë konkrete dhe shoqërore të kësaj veprë penale.

E dëmtuara Arjeta Daqaj nuk e ka kundërshtuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale ndaj të akuzuarit, si dhe nuk kërkon kompensimin e dëmit për dëmin e shkaktuar.

Gjykata konform dispozitave të nenit 364 të KPPK-së, e pasi që janë plotësuar kushtet e parapara sipas dispozitave të nenit 241 të njëjtit Kod, për shkak se i akuzuari në fillim të seancës të shqyrtimit fillestar është deklaruar i fajshëm, në tërësi ka pranuar veprën penale për të cilën akuzohet, gjykata nuk është lëshuar në procedurën e administrimit të provave.

## **2. Vlerësimi i pranimin të fajësisë**

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, gjyqtari i vetëm gjykues pas dëgjimit të palëve ka marr aktvendim me të cilin ka pranuar pranimin e fajësisë ngase ka ardhur në përfundim se

pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me nenin 241 të KPP-së. Gjatë pranimit të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatoi se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjet që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike dhe se nuk ekziston asnjë nga rrethanat e parapara në nenin 248 paragrafët 1 dhe 2 të KPPK-së, për pushimin e procedurës penale përkatësisht hedhjen e aktakuzës.

### 3. Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë gjyqtari i vetëm gjykues ka vërtetuar këtë gjendje faktike: - se i akuzuari M.G, ka kryer veprë penale Ngasja në gjendje të paaftë apo të dehur nga neni 371 par. 3 lidhur me par. 1 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### 4. Elementet e veprës penale

Në nenin 357 par.3 lidhur me par 1 të KPRK-së, është parashikuar se formën themelore të veprës penale Ngasja në gjendje të paaftë apo të dehur e kryen: “ **Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni rezulton me lëndim të rëndë trupor të ndonjë personi ose dëm pasuror në vlerë prej njëzetmijë (20.000) Euro apo më shumë, kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në tet (8) vjet. E në paragrafin 1 parashifet se: ‘Kushdo që drejton automjetin në gjendje të paaftë apo nën ndikim të alkoolit nëse në gjak ka alkool mbi 0.05g/kg respektivisht me sasi përkatëse në miligram për litër të ajrit të nxjerrë apo të substancave tjera dehëse nëse shkaktohet aksident dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet’**”.

### 5. Vendimet e gjyqtarit të vetëm gjykues

Andaj, duke u bazuar në këto që janë cekur më lartë, gjyqtari i vetëm gjykues të akuzuarin M.G, e ka shpallur fajtor sipas aktakuzës së lartcekur, ngase në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale Ngasja në gjendje të paaftë apo të dehur nga neni 371 par. 3 lidhur me par.1 të KPRK-së, dhe për këtë ka vendosur që edhe ta gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij dhe gjendjen e tillë faktike e mori ashtu sikurse ishte përcaktuar në aktakuzë dhe provat të cilat i përmbante aktakuza, e të cilat janë:

- Raporti i aksidentit me nr. 2023-ER-853 i datës 20.11.2023;
- Raporti i hetuesit H.D#4254 mbi vendshiqimin e aksidentit me nr.2023-ER-853 i datës 20.11.2023;
- Deklarata e të pandehurit M.G dhënë në polici me datë 20.11.2023;
- Deklarata e të pandehurit M.G dhënë në Prokurori me datë 22.11.2023;?
- Deklarata e të dëmtuarës A.D dhënë në Polici me datë 13.01.2024;
- Raporti mjekësor lëshuar nga Reparti i Emergjencës pranë Spitalit Rajonal ‘‘Isa Grezda’’ Gjakovë, me nr.rendor 18702 i dat.20.11.2023;
- Raporti mjekësor lëshuar nga Reparti i Emergjencës pranë Spitalit Rajonal ‘‘Isa Grezda’’ Gjakovë, me nr, rendor 18703 i dat.20.11.2023;
- Akt Ekspertiza mjekoligjore e Dr.N.U-Ekspert i Mjekësisë Ligjore dat 17.12.2023;
- Foto dokumentacioni;
- Si dhe shkresat e tjera të lëndës.

Prandaj në bazë të këtyre provave dhe vetë pranimit të fajësisë, gjykata ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e qenies së veprës penale, të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ta gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

## **6. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit**

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuari: se është i gjendjes së varfër ekonomike, pranimin e fajësisë në shqyrtimin fillestar, ndërsa rrethana veçanërisht rënduese nuk gjeti. Kështu që duke mos gjetur rrethana tjera rënduese për të akuzuarin, gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimet e shqiptuara si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi, do të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimit nga neni 38, dhe 48 i KPRK-së, dhe këto dënime si i tilla të shqiptuara sipas bindjes së gjykatës janë në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari dhe se dënimet e shqiptuara do të ndikojnë në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjë rehabilitimin e tij, do të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe do të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

## **7. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale.**

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarës që kërkesën pasurore – juridike ta realizojë në procedurën e rregullt civile bazohet në nenin 462 të KPPK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e paushallit gjyqësor bazohet në nenin 452 par.1 të KPPK-së, ndërsa vendimi për kompensimin e viktimave të krimit u mor në kuptim të nenit 36 paragrafi 3 nënparagrafi 3.1 të Ligjit Nr.08/L – 109, për kompensimin e viktimave të krimit.

Nga sa u tha më lartë e në vështrim të nenit 364 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-DEGA NË RAHOVEC**  
**Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal**  
**P.nr.2023:293346, me datë 11.06.2024**

**B.profesional**  
**Afrim Gashi**

**Gjyqtari i vetëm gjykues**  
**Mizahir Shabani**

**UDHËZIMI JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.